L I G J
Nr.9600, datë 27.7.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në shkronjën "a" të paragrafit të parë të nenit 10, shifra "23,5" bëhet "17,5".

Neni 2

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:
1. Në shkronjën "c" të pikës 1, shifra "29,9" bëhet "23,9".
2. Në shkronjën "b" të pikës 2, shifra "5" bëhet "2".

Neni 3

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 15
Pagesa e kontributeve

Punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit, përjashtuar personat e vetëpunësuar në bujqësi, i paguajnë kontributet në fondin e sigurimeve shoqërore, sipas afatit dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Të vetëpunësuarit në bujqësi i paguajnë kontributet gjatë vitit kalendarik, një herë në tre muaj. Afati i fundit i pagesës së tyre është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik.

Këshilli i Ministrave përcakton mënyrën dhe procedurat e derdhjes së kontributeve.

Akti, që përmban detyrimin për pagesën e kontributeve, përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e përmbarimit.".

Neni 4

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 16
Sanksionet

Ndaj punëdhënësve dhe të vetëpunësuarve, përjashtuar personat e vetëpunësuar në bujqësi, që nuk zbatojnë afatet dhe procedurat e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore, zbatohen sanksionet e përcaktuara në ligjin nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Nëse personat e vetëpunësuar në bujqësi nuk i paguajnë kontributet në afatet e përcaktuara në këtë ligj, ata detyrohen të paguajnë kamatëvonesa, të cilat llogariten mbi shumën e kontributeve të papaguara,

nga data në të cilën pagesa ka qenë e detyrueshme deri në datën në të cilën kryhet pagesa.

Kamatëvonesa për kontributet e paguara jashtë afateve është 2 për qind për muajin e parë ose pjesë të tij dhe 1 për qind për çdo muaj që vijon. Kamatëvonesa zbatohet e plotë, si në rastin kur vonesa është për 1 muaj të plotë, ashtu edhe kur periudha e vonesës është më e vogël se një muaj.

Kamatëvonesat llogariten nga inspektorët e agjencive të sigurimeve shoqërore.”.

Neni 5

Neni 81 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 81
Regjistrimi

Personat juridikë, publikë e privatë dhe personat fizikë, që fillojnë veprimtari ekonomike për herë të parë, janë të detyruar të regjistrohen në agjencitë e sigurimeve shoqërore.

Regjistrimi është një akt administrativ, që nuk tregon detyrim për mbulimin me sigurime shoqërore.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5020, datë 4.8.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu